

LIGJ
Nr.10 128, datë 11.5.2009

PËR TREGTINË ELEKTRONIKE¹

(version i konsoliduar me ndryshimet e miratuara me ligjin Nr. 135/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10128 dt. 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike”)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

Objekti i këtij ligji është vendosja e rregullave për kryerjen e veprimeve tregtare në rrugë elektronike, nëpërmjet shërbimeve të ofruara nga shoqëria e informacionit, për mbrojtjen e personave pjesëmarrës, mbrojtjen ligjore të konfidencialitetit të konsumatorëve apo e të dhënave konfidenciale të pjesëmarrësve në të, si dhe për të siguruar lëvizjen e lirë të shërbimeve të informacionit, duke përcaktuar përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve të shoqërisë së informacionit.

Neni 2
Fusha e veprimit

1. Ky ligj zbatohet për shërbimet e shoqërisë së informacionit kundrejt personave fizikë a juridikë, përfitues të tyre, me përjashtim:
- a) të veprimeve noteriale ose veprimeve të tjera të ngjashme, që lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e autoritetit publik;
 - b) të përfaqësimit të personave dhe mbrojtjen e interesave të tyre para gjykatave, si dhe në çdo organ, ku paraqitja e personit mund të bëhet nga të tretët, nëpërmjet akteve të përfaqësimit;
 - c) të veprimtarisë me pagesë për pjesëmarrjen e lojtarëve në bastet, lotaritë, lojërat e fatit, lojërat elektronike, hipodromet dhe kazinotë.
2. Ky ligj nuk i shtrin efektet për marrëdhëniet juridike, që krijohen:
- a) në fushën e tatim-taksave;

¹ Perafruar me Direktiven 2000/31/EC, “on Some legal aspects of Information Society services, especially on electronic commerce in domestic market (Directives on Electronic Commerce)”, me CELEX 32000L0031.

- b) për mbrojtjen e të dhënave personale;
- c) për çështjet, që lidhen me praktika e marrëveshje, të rregulluara nga ligji i konkurrencës.
- d) për çështjet që lidhen me të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale.

Neni 3 **Përkufizimet**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Shërbimet e shoqërisë së informacionit" janë shërbimet, që ofrohen përkundrejt pagesës, në distancë, nëpërmjet mjeteve elektronike dhe me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit.

Me fjalët:

i) "Në distancë" nënkuptohet se shërbimi ofrohet pa qenë e nevojshme që të dyja palët të jenë të pranishme në të njëjtën kohë.

ii) "Nëpërmjet mjeteve elektronike" nënkuptohet se shërbimi dërgohet nga pika e origjinës dhe merret në destinacionin përfundimtar, me anë të pajisjeve elektronike, për përpunimin (përfshirë edhe kompresimin numerik) dhe ruajtjen e të dhënave.

Dërgimi, transmetimi dhe marrja e plotë bëhen nëpërmjet kablllove, radiovalëve, mjeteve optike dhe mjeteve të tjera elektromagnetike.

iii) "Me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit" nënkuptohet se shërbimet ofrohen nëpërmjet transmetimit të të dhënave, me kërkesë individuale të marrësit.

Shërbimet e shoqërisë së informacionit përfshijnë, në veçanti, shitjen e mallrave e të shërbimeve, shërbimet e aksesit të informacionit apo të reklamave në internet e të aksesit në shërbimet e rrjeteve publike të komunikimit, transmetimin e të dhënave ose ruajtjen e të dhënave të marrësit në rrjetin publik të komunikimeve.

b) "Ofruesi i shërbimit" është çdo person fizik ose juridik, që ofron një shërbim të shoqërisë së informacionit.

c) "Ofrues shërbimi të themeluar" është personi fizik apo juridik, që ofron shërbimin dhe që ushtron veprimtarinë ekonomike në mënyrë të përhershme e që ka një seli të vet të regjistruar.

Ekzistenca dhe përdorimi i mjeteve teknike dhe i teknologjive të kërkuara për ofrimin e shërbimit nuk përbën, në vetvete, themelim të ofruesit.

ç) "Marrësi i shërbimit" çdo person fizik ose juridik, i cili, për qëllime profesionale a të ndryshme, në mënyrë të veçantë, për qëllime të kërkimit të informacionit dhe bërjen e tij të aksesueshëm, përdor një shërbim të shoqërisë së informacionit.

d) shfuqizohet

dh) "Konsumator" është çdo person fizik, i cili blen ose përdor mallra a shërbime për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime, të cilat nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare, biznesin ose ushtrimin e profesionit.

e) "Komunikimi tregtar" është çdo mënyrë komunikimi e dizenuar për nxitjen e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të mallrave, të shërbimeve ose imazhin e një tregtari a shoqërie tregtare, organizate jofitimprurëse apo personi që kryen një veprimtari tregtare, industriale a zejtarie ose

ushtron një profesion të rregulluar.

Nuk janë komunikime tregtare, në kuptim të këtij ligji:

i) informacionet, që lejojnë akses të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e shoqërisë, të organizatës ose personit, në veçanti zotërimi i domenit ose adresa e postës elektronike.

ii) komunikimet, që lidhen me mallra, shërbime ose me imazhin e tregtarit a të shoqërisë tregtare, organizatës jofitimprurëse ose personit, të grumbulluara në mënyrë të pavarur, në ato raste kur kjo është bërë pa kosto financiare.

ë) "Profesione të rregulluara" janë të gjitha ato profesione, mënyra e ushtrimit e të cilave është rregulluar me ligj të veçantë.

f) "Tregti elektronike" është kryerja nga subjektet e këtij ligji të një veprimtarie, nëpërmjet shkëmbimit të dokumenteve elektronike, për tregtimin e mallrave dhe/ose të shërbimeve.

“g. “Fusha e koordinuar” janë rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për shërbimet e shoqërisë së informacionit dhe ofruesit e shërbimit, si dhe rregullat për krijimin dhe operimin e shërbimeve të shoqërisë së informacionit, pavarësisht nëse ato janë te natyrës së përgjithshme apo te projektuara specifikisht për to.”

gj) “Regjistri i përjashtimeve” është regjistri që ofruesi i shërbimit mban për regjistrimin e personave, të cilët nuk kanë dëshirë të marrin komunikime tregtare të pakërkuara.

h) “Transmetimi i thjeshtë” (mere conduit) është shërbimi i ofruar nga një ofrues shërbimi për sigurimin e aksesit në rrjetin e komunikimit ose për sigurimin e shërbimit të transmetimit të të dhënave.

i) “Caching” është ruajtja e përkohshme, automatike e të dhënave të ofruara nga përdoruesi, me qëllim transmetimin në mënyrë më të efektshme të informacionit dhe për aksesimin më të shpejtë të informacionit në rast ripërdorimi nga përdoruesi.

j) “Hosting” është shërbimi i ruajtjes së të dhënave nga ofruesi i shërbimit, ku të dhënat e ruajtura zgjidhen dhe ngarkohen nga marrësi i shërbimit.

Neni 4

Parime të përgjithshme

1. Veprimet tregtare, të kryera në rrugë elektronike, bazohen në parimet e barazisë së pjesëmarrësve, të vullnetit të lirë, lirisë kontraktuale, zhvillimit të lirë të veprimtarisë sipërmarrëse, si dhe në lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Në fushën e tregtisë elektronike, palët pjesëmarrëse nuk mund të vendosin kufizime për blerjen dhe përmbushjen e të drejtave e të detyrimeve të personave fizikë dhe juridikë, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

Neni 5

Zbatimi i ligjit

1. Ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit, me seli në Republikën e Shqipërisë, e ushtron veprimtarinë në mënyrë të veçantë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
2. Ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, për të ofruar shërbimet e veta në distancë, siguron që këto shërbime:
 - a) të mos cenojnë të drejtat e njeriut;
 - b) të garantojnë mbrojtjen e konsumatorit dhe të investitorëve, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
 - c) të sigurojnë mbrojtjen e minoreneve;
 - ç) të vendosin masa mbrojtëse për mosndërhyrjen në shërbimet e tij dhe mospërdorimin e tyre për qëllime kriminale;
 - d) të ofrohen për të gjithë klientët njëjloj, pa dallime ndërmjet sekseve, racave, besimit, etnisë apo bindjeve të personave që i përfitojnë ato;
 - dh) të mos cenojnë sigurinë kombëtare dhe sigurinë e publikut;
 - e) të mos cenojnë shëndetin publik;
 - ë) të ofrohen, në çdo rast, me pëlqimin paraprak të përfituesit të shërbimit.

Neni 5/1

Ofrimi i shërbimeve të shoqërisë së informacionit nga vendet anëtare të BE-së

Ofrimi i shërbimeve të shoqërisë së informacionit, nga një ofrues shërbimi, i themeluar në një vend anëtar i Bashkimit Europian, për arsye që i përkasin fushës së rregullimit të koordinuar, nuk kufizohet në Republikën e Shqipërisë.

KREU II

E DREJTA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Neni 6

E drejta e ofrimit të shërbimit

1. Çdo person fizik ose juridik në Republikën e Shqipërisë është i lirë të ofrojë shërbime të shoqërisë së informacionit pa autorizim paraprak, ose ndonjë kërkesë tjetër që ka efekt të ngjashëm me të.
2. Nuk i nënshtrohen parashikimeve të pikës 1 të këtij neni:
 - a) ofruesit e shërbimeve, të cilët kanë detyrimin për t'u pajisur me autorizim, sipas ligjit "Për

komunikimet elektronike".

b) ofruesit e shërbimeve financiare ose të sigurimeve, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mbështetje të ligjeve, që rregullojnë mënyrën e organizimit e të ushtrimit të veprimtarisë për këto shërbime.

Neni 7

Detyrimi për informacion të përgjithshëm

1. Ofruesi i shërbimit në ushtrimin e veprimtarisë siguron për marrësit e shërbimit dhe për autoritetet përkatëse informacion, të paktën, për:

a) emrin tregtar të ofruesit të shërbimit dhe, nëse nuk ka të tillë, emrin me anë të të cilit ai është regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë;

b) adresën e vendit, në të cilën është vendosur selia apo qendra kryesore e veprimtarisë së ofruesit të shërbimit;

c) adresën e postës elektronike apo çdo detaj tjetër që lejon komunikimin e shpejtë dhe efikas me ofruesin e shërbimit;

ç) të dhënat e regjistrimit në regjistrin tregtar të ofruesit të shërbimit, sidomos numrin unik të identifikimit të personit;

d) të dhëna të veçanta të autoritetit përgjegjës mbikëqyrës, kur veprimtaria e ofruesit të shërbimit është objekt i ushtrimit të saj nëpërmjet pajisjes së tij me autorizim të veçantë;

dh) profesionet e rregulluara, duke treguar edhe:

i) entin publik profesional ose institucionin e ngjashëm me të, ku ofruesi i shërbimit është i regjistruar;

ii) titullin profesional dhe shtetin e lëshimit apo të fitimit të tij;

iii) referimin për rregullat, që rregullojnë profesionin dhe juridiksionin e zbatuar në shtetin e krijimit të tij, si dhe mjetet për informim për to;

e) numrin unik të identifikimit të subjektit apo NIPT-in.

2. Ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit jep informacionin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, në mënyrë të qartë, të saktë dhe lehtësisht të kuptueshëm, për mallrat apo shërbimet, që ai ofron ose parashikon të ofrojë në të ardhmen, veçanërisht për çmimet. Informacioni duhet të jetë i qartë dhe lehtësisht i kuptueshëm, se çmimi i ofruar prej tij është përfundimtar dhe se në të janë përfshirë tatimi e kostot e transportit apo të dërgimit të tij deri në destinacionin përfundimtar, të përfituesit apo të marrësit.

3. Në çdo rast, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit është i detyruar që, në informacionet që jep, veç parashikimeve të këtij ligji, të respektojë edhe parashikimet e ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorit".

KREU III

KOMUNIKIMET TREGTARE

Neni 8

Kushtet për ofrimin e informacionit

Ofruesi i shërbimeve të shoqërisë së informacionit në komunikimet tregtare, të ci lat janë pjesë apo përbëjnë një shërbim të shoqërisë së informacionit, siguron se këto komunikime plotësojnë të paktën kushtet e mëposhtme:

- a) janë qartësisht të identifikueshme nga të tretët si komunikime tregtare;
- b) bëjnë të mundur identifikimin e qartë të personit fizik ose juridik, në emër dhe për llogari të të cilit janë bërë këto komunikime tregtare;
- c) në rastin e ofertave promovionale, që sjellin si pasojë uljen e çmimit, fitimin e ndonjë çmimi apo të dhuratave të lejuara, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të ketë të identifikuar qartë të dhënat e mësipërme, si dhe duhet të paraqesë në mënyrë të qartë, lehtësisht të arritshme dhe pa dyshim, kushtet që duhen plotësuar për kualifikim;
- ç) në rastin e konkurseve apo të lojërave promovionale, nëse këto janë të lejuara sipas legjislacionit në fuqi, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit duhet t'i ketë të identifikuar qartë ato si të tilla, si dhe të paraqesë për të tretët, në mënyrë të qartë, lehtësisht të arritshme dhe pa asnjë dyshim, kushtet për pjesëmarrjen e tyre.

Neni 9

Komunikimet tregtare të pakërkuara

1. Komunikimet tregtare të pakërkuara nëpërmjet postës elektronike ose me sms lejohen vetëm me miratimin paraprak të marrësit të tyre.
2. Komunikimet tregtare të pakërkuara nëpërmjet postës elektronike, në ato raste kur sipas legjislacionit janë të lejuara, duhet të identifikohen qartë dhe pa dyshim si të tilla, që në çastin fillestar të marrjes së tyre prej marrësit.
3. “Çdo ofrues i shërbimeve, që ofron komunikime tregtare të pakërkuara nëpërmjet postës elektronike, mban një regjistër përjashtimesh, ku regjistrohen personat, të cilët nuk kanë dëshirë të marrin komunikime tregtare të pakërkuara. Ofruesit e shërbimeve, janë të detyruar të kontrollojnë rregullisht dhe të respektojnë regjistrin e përjashtimeve.

Neni 10

Profesionet e rregulluara

1. Komunikimet tregtare, që janë pjesë apo përbëjnë një shërbim të shoqërisë së informacionit, të ofruar nga anëtarët e profesioneve të rregulluara, u përmbahen rregullave për ushtrimin e profesionit, veçanërisht për pavarësinë, dinjitetin, nderin e profesionit, sekretin profesional dhe ndershmërinë kundrejt klientit dhe anëtarëve të tjerë të profesionit.
2. Qëllimet e komunikimeve tregtare, që ofrohen nga ana e profesioneve të rregulluara, parashikohen në kodet e sjelljes apo të etikës së tyre, të cilat përfshijnë llojin e informacionit, që mund të jepet për qëllime të komunikimeve tregtare, sipas parashikimeve të përcaktuara në pikën

1 të këtij neni.

KREU IV KONTRATAT E LIDHURA NËPËRMJET MJETEVE ELEKTRONIKE

Neni 11

Kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e kontratave

1. Kontratat e lidhura përmes mjeteve elektronike quhen kontrata në formë elektronike.
2. Propozimi dhe pranimi i ofertës mund të bëhen nëpërmjet mjeteve elektronike, që është forma elektronike e tyre. Në çdo rast, që kontrata elektronike të jetë e vlefshme, duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e parashikuara nga Kodi Civil, për pjesën e përgjithshme të kontratave, kërkesat e parashikuara për formën konkrete të kontratës, të parashikuar nga Kodi Civil dhe kërkesat e veçanta, të parashikuara në ligjin nr.9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

Neni 12

Kontratat e përjashtuara nga fusha e veprimit të këtij ligji

Ky ligj nuk zbatohet për kontratat e mëposhtme:

- a) për kontratat e lidhura për të krijuar, ndryshuar apo shuar të drejta mbi sendet e paluajtshme, përveç kontratës së qirasë për pasuri të paluajtshme me afat deri në 9 vjet;
- b) për kontratat, që me ligj kërkojnë përfshirjen e gjykatave, të autoriteteve publike dhe profesioneve, që ushtrojnë apo japin një shërbim publik;
- c) për kontratat e garancisë dhe kolaterali i letrave me vlerë, i dhënë nga persona, që veprojnë për qëllime të ndryshme nga ato të biznesit, tregtisë apo profesionit të tyre;
- ç) për kontratat e parashikuara nga Kodi i Familjes dhe veprimet juridike, të parashikuara nga Kodi Civil pjesa III titulli III "Trashëgimia me testament";
- d) për shërbimet financiare ose shërbimet e sigurimit, për të cilat zbatohet marketingu në distancë.

Neni 13

Informacioni që duhet ofruar

1. Ofruesi i mallit dhe/ose shërbimit jep informacion të plotë, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, si dhe përpara se të bëhet kërkesa nga marrësi i shërbimit, për:
 - a) hapat e ndryshëm proceduralë, që do të ndiqen për lidhjen e kontratës;
 - b) kushtet kontraktore të palëve;
 - c) mënyrat teknike për identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve, përpara paraqitjes së kërkesës/porosisë;
 - ç) gjuhët e ofruara për lidhjen e kontratës;

d) faktin nëse kontrata e lidhur do të arkivohet nga ofruesi i shërbimit dhe nëse do të ketë akses te kjo kontratë.

2. Në rastet kur palët, që nuk janë konsumatorë, bien dakord ndryshe nga sa kërkohet në pikën 1 të këtij neni, ofruesi i shërbimit tregon Kodin e Etikës, ku përshkruhet edhe mënyra e konsultimit të këtij kodi në formë elektronike.

3. Termat e kontratës dhe kushtet e përgjithshme të saj i jepen marrësit në atë mënyrë, që ai të mund t'i ruajë, përdorë dhe riprodhojë ato për qëllimet e kësaj marrëdhënieje.

4. Pikat 1 e 2 të këtij neni nuk zbatohen për kontratat e lidhura ekskluzivisht nëpërmjet shkëmbimit të postës elektronike apo komunikimeve individuale, ekuivalente.

Neni 14

Lidhja e kontratës

1. Ofruesi i shërbimit jep një fletëpërmbledhje të kushteve, të përgjithshme e të veçanta, që i aplikohen kontratës, si dhe njofton pa vonesë për marrjen e porosisë nga marrësi i shërbimit nëpërmjet mjeteve elektronike, përveç rasteve kur palët jokonsumatore bien dakord ndryshe.

2. Kontrata elektronike quhet e lidhur kur ofruesi merr një mesazh elektronik, që përmban deklarinimin e marrjes së konfirmimit dhe pranimit e ofertës.

3. Propozimi dhe pranimi i ofertës, të bërë nga palët në marrëdhënien juridike, që lind për shkak të tregtisë elektronike ndërmjet tyre, vlerësohen se janë marrë, kur palët, paraprakisht, t'i kenë provuar njëra-tjetrës se janë në gjendje t'i marrin ato në rrugë elektronike. Në këtë rast, parashikimet e Kodit Civil për pranimit apo refuzimin e ofertës, të parashikuara në kushtet e përgjithshme të kontratave, janë të zbatueshme edhe për këtë qëllim.

KREU V

PËRGJEGJËSITË E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE NDËRMJETËSE

Neni 15

Transmetimi i thjeshtë, (mere conduit)

1. Kur ofrimi i shërbimit të shoqërisë së informacionit konsiston në transmetimin një rrjet komunikimi të informacionit të siguruar nga marrësi i shërbimit, ose në ofrimin e aksesit në një rrjet komunikimi, ofruesi i shërbimit nuk është përgjegjës për informacionin e transmetuar nëse ofruesi i shërbimit:

- a) nuk inicion transmetimin
- b) nuk zgjedh ose modifikon përmbajtjen e informacionit të transmetuar
- c) nuk zgjedh marrësin e transmetimit

2. Veprimet e transmetimit dhe të ofrimit të aksesit, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshijnë ruajtjen automatike, të menjëhershme dhe të përkohshme të informacionit të transmetuar vetëm për

përcjelljen e transmetimit në një rrjet komunikimi, duke siguruar ruajtjen e informacionit për aq kohë sa nevojitet për transmetim.

Neni 16

Ruajtja e përkohshme e informacionit (Caching)

Gjatë transmetimit të informacionit në rrjetin e komunikimit, ofruesi i shërbimit, që ofron transmetimin e informacionit, nuk është përgjegjës për ruajtjen e përkohshme, të ndërmjetshme dhe automatike, të kryer vetëm për rritjen e efikasitetit të transmetimit të informacionit të marrësit e tjerë të shërbimit, në bazë të kërkesës së tyre, nëse ofertuesi:

- a) nuk modifikon informacionin;
- b) përmbush/vepron, në përputhje me kushtet e aksesit të informacionit;
- c) përmbush/vepron në përputhje me rregullat për përditësimin e informacionit, në një mënyrë të specifikuar, të mirënjohur dhe të përdorur gjerësisht;
- ç) nuk ndërhyt nëpërmjet përdorimit të ligjshëm të teknologjisë së njohur dhe të përdorur gjerësisht nga industria e komunikimeve elektronike, për marrjen e të dhënave mbi përdorimin e informacionit;
- d) vepron me shpejtësi, për të hequr ose çaktivizuar aksesin në informacionin e ruajtur, pasi njihet me faktin se informacioni në burimin fillestar të transmetimit është hequr nga rrjeti, aksesin në të është çaktivizuar ose organet përgjegjëse kanë urdhëruar heqjen apo çaktivizimin.

Neni 17

Hosting

1. “Kur një shërbim i shoqërisë së informacionit konsiston në ruajtjen e informacionit të siguruar nga marrësi i shërbimit, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit nuk është përgjegjës për informacionin e ruajtur me kërkesën e marrësit të shërbimit, nëse ofruesi i shërbimit:

- a) nuk ka ose nuk mund të ketë dijeni për veprimtarinë e paligjshme të marrësit ose të përmbajtjes së informacionit dhe, për sa u përket pretendimeve për dëme, nuk është në dijeni të fakteve a rrethanave prej të cilave rrjedh aktiviteti apo informacioni i paligjshëm;
- b) me marrjen e këtij informacioni, vepron menjëherë për të hequr ose çaktivizuar aksesin në informacion.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet kur marrësi i shërbimit vepron në emër ose në kontrollin e ofruesit të shërbimit.

Neni 18

Mjetet e kërkimit të informacionit

Ofruesit e shërbimit, të cilët krijojnë, nëpërmjet mjeteve elektronike, akses në informacion për palët e treta, nuk janë përgjegjës për këtë informacion, nëse:

- a) nuk kanë dijeni ose nuk mund të kenë dijeni për veprimtarinë e paligjshme të marrësit ose rreth të dhënave që përmban informacioni;
- b) me vënie në dijeni të faktit për veprimtari të paligjshme ose të të dhënave, heqin a çaktivizojnë aksesin për këto të dhëna.

Neni 19

Ndërprerja ose parandalimi i shkeljeve

Pavarësisht nga sa parashikohet në dispozitat e këtij ligji, në veçanti në nenet 15, 16, 17 e 18, ofruesi i shërbimit është i detyruar të ndërpresë ose të parandalojë një shkelje, nëse kjo kërkohet nga gjykata ose nga autoritetet përgjegjëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 20

Detyrimet e ofruesit të shërbimit

1. Ofruesit e shërbimeve të shoqërisë së informacionit, që janë objekt i këtij kreu, nuk kanë detyrim për mbikëqyrjen e informacionit, që ata transmetojnë ose ruajnë, si dhe për kërkimin e fakteve apo të situatave, që tregojnë një veprimtari të paligjshme.
2. Ofruesit e shërbimit të shoqërisë së informacionit njoftojnë menjëherë autoritetet përgjegjëse, nëse kanë dyshime të arsyeshme se përdoruesit e shërbimeve:
 - a) janë duke kryer veprimtari të paligjshme;
 - b) kanë paraqitur informacion ilegal.
3. Ofruesit e shërbimeve u paraqesin organeve përgjegjëse, në bazë të kërkesës së tyre dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, të gjithë informacionin, që mundëson identifikimin e marrësit të këtyre shërbimeve.

KREU VI

AUTORITETET MBIKËQYRËSE DHE SANKSIONET

Neni 21

Autoritetet zbatuese

1. shfuqizohet
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve, të përcaktuara në këtë ligj, ngarkohen Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit, të përcaktuara në ligjin "Për mbrojtjen e konsumatorit".
3. Për qëllime të mbikëqyrjes, ofruesit e shërbimit të shoqërisë së informacionit u ofrojnë personave të autorizuar akses në pajisjet kompjuterike dhe japin, pa vonesë, informacionin dhe

dokumentet e transmetuara, që kanë lidhje me subjektin e mbikëqyrjes.

Neni 21/1

Pikat e kontaktit dhe kooperimi

1. Autoritetet zbatuese bashkëpunojnë për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj. Autoritetet zbatuese, brënda 90 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, përcaktojnë pikat e kontaktit për bashkëpunimin me shtetet anëtare dhe Komisionin e Bashkimit Europian dhe ku ofruesit dhe marrësit e shërbimeve të shoqërisë së informacionit:

a) sigurojnë informacion të përgjithshëm mbi të drejtat dhe detyrimet kontraktore, mbi ankesat dhe mekanizmet e demshperblimit ne dispozicion ne rast mosmarrëveshjeje, si dhe aspekte praktike të përdorura në këto mekanizma sipas legjislacionit në fuqi.

b) sigurojnë informacionin për autoritetet, ose organizatat kompetente që ofrojnë informacion shtesë ose asistencë praktike sipas legjislacionit në fuqi.

2. Autoritetet zbatuese sigurojnë që pikat e kontaktit janë të arritshme në rrugë elektronike.

Neni 22

Sanksionet

1. Një person juridik, ofrues i shërbimit të shoqërisë së informacionit, dënohet me gjobë 200 000 (dyqind mijë) lekë, për rastet e mëposhtme:

a) shkelje të detyrimit për informacion të përgjithshëm (neni 7);

b) shkelje të detyrimit për informacion të përgjithshëm për komunikimet tregtare (neni 8);

c) shkelje të detyrimit për sigurimin e aksesit për lidhjen e kontratës (neni 13 pika 1);

ç) mosrespektim të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji për mosdhënien e aksesit për marrësin e shërbimit, në mënyrë që t'i ruajë, përdorë dhe riprodhojë ato;

d) shkelje të detyrimeve të pikave 2 e 3 të nenit 20 të këtij ligji;

dh) mosdhënie akses në pajisjet kompjuterike dhe të informacionit për personat e autorizuar, sipas pikës 3 të nenit 21 të këtij ligji.

e) për mosrespektim të nenit 9 për komunikimet tregtare të pakërkuara.

2. Nëse shkeljet e mësipërme janë kryer nga persona fizikë, ofrues të shërbimit të shoqërisë së informacionit, në këtë rast ata dënohen me gjobë 100 000 (njëqind mijë) lekë.

3. Shkeljet e parashikuara nga ky ligj, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe, sipas fushës së tyre të veprimit, autoritetet mbikëqyrëse vendosin gjobat, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Neni 23
Ankimi

Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ose e njoftimit të tij.

Neni 24
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve, që rrjedhin nga hyrja në marrëdhënie me njëri-tjetrin, për shkak të ofrimit dhe të pranimit të shërbimeve në distancë, zgjidhen nga gjykata e arbitrazhit, sipas klauzolave të arbitrazhit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Në rast mungese të marrëveshjes për arbitrazh, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata e rrethit gjyqësor.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 25/1

Neni 5/1 hyn në fuqi në datën e aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Shpallur me dekretin nr.6179, datë 25.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi